

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Ramiz Azizi, me zyrtaren ligjore Florentina Ademi, në lëndën penale ndaj të akuzuarit K.M, nga fsh. P K-Gj, për shkak të veprës penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2218/16, e datës 15.12.2016, të cilën e përfaqësonte prokurori Shefik Mehmeti, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 11.05.2017, mori dhe shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari K. M nga i ati F dhe nëna H, e lindur R, i lindur me date: ..në Gjme vendbanim në fsh.P K.Gj ,i pa martuar, ka te kryer shkollen e mesme ,i pa pune ,i gjendjes së varfer ekonomike , shqiptar , Shtetas i Republikës se Kosoves.

Eshte Fajtor

Me datë 24.11.2016 rreth ores 21:00 minuta,ne fsh.P te Komunes se Gj,ne restorantin,,...,per shkak të një zenke të momentit, i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarin nga fsh. ne ate menyre qe fillimisht e pyet se pse po me shikon dhe me pas e merr nje shishe te birres(të qelqit)dhe me te njejten e godet ne koke,me q'rast te njejtit i shkakton lendime te lehta trupore ne forme te gervishtjeve prerjes dhe ndrydhjeve dhe te indeve te buta te kokes,me pasoja te perkohshme per shendetin,

- me qka ka kryer veprën penale, Lendim i lehte trupor nga neni 188 paragrafui 1,nen paragrafi 1.4 te KPRK-së.

Andaj gjykata ne bazë te dispozites se lartcekur ligjore dhe neneve 4,7,17,21,49,50,51,52,73,74 te KPRK-së si dhe nenet 365,451 dhe 463, KPPK,te pandehurit i shqipton

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarit K. M i caktohet dënimi me kusht në kohëzgjatje prej 100 (njëqind) ditëve, të cilin dënim I akuzuari nuk do ta mbajë, nëse në afat prej 1 (një) viti, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Pala e dëmtuar,per realizimin e kerkeses pasurore-juridike,udhezohet ne konteste civil.

Detyrohet që i akuzuari t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 25 €, në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shpenzimet e tjera të procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i përgjithshëm, ka paraqitur propozim akuzën e lartcekur ndaj të akuzuarit për shkak të veprës penale Lendimi i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4. të KPRK-së.

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, të mbajtur më datën 11.05.2017, prokurori Shefik Mehmeti, gjatë fjalës përfundimtare, deklaroi: mbes ne tërësi pranë aktit akuzues pasi që në shqyrtimin e sotëm fillestar I pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barre, për të cilën pranim gjykata e ka njoftuar me pasojat dhe favore të pranimit të tij. Mbi bazën e këtij pranimi dhe provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lendes i propozoj gjykatës që tepandehurin ta shpall fajtor dhe ta dënoj me dënim meritore sipas ligjit. I cili dënim do të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore të kësaj veprë penale.

I akuzuari në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se është hera e parë kam kryer veprë penale dhe i premtoj gjykatës se një gjë të tillë më nuk do ta përsëris, dhe kërkoj nga gjykata që të ma shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit të palëve, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, ngase I akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga I akuzuari; pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban propozimakuza, si dhe propozimakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike : Se i akuzuari, nga fsh.P, pa dashje e ka kryer veprën penale, Lendimim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 të KPRK-së.

*Gjyqtari i vetëm gjykues, e shpalli fajtor të akuzuarin për shkak të veprave penale, **Lendimi i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4. i KPRK-s.** ngase veprimet e të njejtës i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj veprë penale dhe se për të njejtën është edhe përgjegjës penalisht.*

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 64 të KPK, ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, se pas këtij rasti nuk kanë pasur ndonjë mosmarrëveshje tjetër; se ka shprehur keqardhje për rastin e ndodhur; se është penduar për kryerjen e kësaj veprë penale, pasi që edhe është i moshës së re, si dhe i ka premtuar gjyqtarit të vetëm gjykues që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të tilla dhe të tjera penale, ndërsa si rrethanë rënduese, gjyqtari i vetëm gjykues e ka marrë për bazë faktin se vepra penale është kryer me dashje.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me kusht, ndaj të akuzuarit Kelmend Maloku, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 50 të KPRK.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, kurse vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Më 11.05.2017

*Zyrtare Ligjore,
Florentina Ademi*

*Gjyqtari i vetëm gjykues,
Ramiz Azizi*

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.